



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2021:279816

Datë: 18.11.2023

Numri i dokumentit: 04939246

P.nr.1000/20

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – Departamenti i përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtarja e vetme gjykuese Ilda Cucović Sahatçiu, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Gylaj Nepola, në çështjen penale kundër të pandehurit Sh.K.nga Peja, me vendbanim në rr. „A.Q.” për shkak se ka kryer veprë penale „Kanosja” nga neni 181 par.2 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.2475/21 të datës 13.12.2021, në bazë të nenit 357 të KPPRK-së dhe nenit 12 dhe 15 të Ligjit për Ndërmjetësim nr.06/L-009, jashtë seancës së shqyrtimit gjyqësor, me datë 18.11.2023, bie këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET marrëveshja për ndërmjetësim me shenjen ND.nr.2184/23 e lidhur me datë 16.11.2023 në mes të pandehurit (pala B) Sh.K.nga Peja, me numër personal dhe të dëmtuarit (pala A) M.I.nga Peja me nr. personal

II. HEDHET – aktakuza e Prokurorisë Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.2475/21 të datës 13.12.2021.

III. PUSHOHET procedura penale ndaj të pandehurit Sh.K.nga Peja, për shkak te veprës penale „Kanosja” nga neni 181 par.2 të KPRK-së, për arsye se i pandehuri dhe i dëmtuari, kanë arritur marrëveshje për ndërmjetësim.

IV. Shpenzimet e procedurës penale i bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm, pranë kësaj gjykate ka ngritur aktakuzë nën shenjen PP/II.nr.2475/21 të datës 13.12.2021 ndaj të pandehurit Sh.K.nga Peja, rr. „A.B.Q.” për shkak te veprës penale „Kanosja” nga neni 181 par.2 të KPRK-së.

Në këtë çështje penale, kjo gjykatë me dt.16.11.2023, ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, në të cilën seancë, gjykata sipas detyrës zyrtare konform dispozitave te Ligjit nr. 06/L-009 për ndërmjetësim dhe Kodit nr. 08/L-032 të Procedurës Penale , ka informuar palët se lënda

penale mund të referohet ne procedurën e ndërmjetësimit me pëlqimin e të pandehurit, të dëmtuarit dhe të Prokurorit të Shtetit, me ç ‘rast palët njëzëri janë deklaruar se pajtohen që çështja penale të referohet në procedurën e ndërmjetësimit, me qëllim të arritjes së marrëveshjes eventuale.

Pas dhënies se pëlqimit të palëve për zgjidhjen e kësaj çështje penale në procedurën e ndërmjetësimit, gjyqtarja e çështjes e ka ndërprerë seancën dhe me datë 16.11.2023, ka marr vendimin për ta dërguar lëndën pranë koordinatorit për ndërmjetësim të kësaj gjykate që të procedoj lëndën në procedurë të ndërmjetësimit.

Me dt. 16.11.2023, në Qendrën e Ndërmjetësimit në Pejë, është lidhur marrëveshja për zgjidhjen e ndërmjetësuar nga ndërmjetësuesi Zymer Metaj, ndërmjet të pandehurit (pala B) Sh.K.nga Peja, me numër personal dhe të dëmtuarit (pala A) M.I.nga Peja me nr. personal

Sipas marrëveshjes së arritur ndërmjet të pandehurit dhe të dëmtuarit, palët kanë deklaruar se marrëveshjen e lidhin në vullnet të plotë dhe pa shtytje nga askush. Njëkohësisht i pandehuri i kërkoj falje të dëmtuarit me ç ‘rast i dëmtuari e pranoj kërkim faljen e të pandehurit dhe nga i njëjti nuk kërkoj kompensim dëmi .

Palët pa ndonjë kërcënim dhe me vet dëshirë kanë shprehur gatishmëri që kjo çështje të zgjidhet me marrëveshje në procedurën e ndërmjetësimit dhe nuk i kontestojnë asnjë nga pikat e lartpërmendura.

Qendra e Ndërmjetësimit me datë 16.11.2023, me numër të lëndës në ndërmjetësim Nd.2184/23, ka lidhur marrëveshjen e palëve të lartpërmendura për zgjidhjen e ndërmjetësuar.

Gjykata duke u bazuar në provat si më lartë dhe në bazë të nenit 357 par.1 nën par. 1.3 të KPPRK-së dhe nenit 12 dhe 15 par.1 të Ligjit për ndërmjetësim, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË
Departamenti I Përgjithshëm
Divizioni Penal
P.nr.1000/20, me datë 18.11.2023

Bashkëpunëtorja profesionale

Gylaj Nepola

Gjyqtarja e vetme gjykuese

Ilda Cucović Sahatçiu

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese, në afat prej 3 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, pranë Gjykatën e Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj Gjykate.